

VENDIM
Nr. 310, datë 26.5.2021

**PËR HEQJEN NGA FONDI PYJOR PUBLIK DHE ZVOGËLIMIN NË VOLUM
TË SIPËRFAQES PREJ 2.874 HA, NË OBJEKTIN “RUBIK”, TË BASHKISË
MIRDITË, QË DO TË PËRDORET NGA SHOQËRIA “VUTHAJ” SHPK, PËR
SHFRYTËZIMIN E MINERALIT TË BAZALTIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës “b”, të pikës 4, të nenit 5, të ligjit nr. 57/2020, “Për pyjet”, me propozimin e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Sipërfaqja pyjore publike prej 2.874 (dy pikë tetëqind e shtatëdhjetë e katër) ha, që do të përdoret nga shoqëria “Vuthaj” sh.p.k., për shfrytëzimin e mineralit të bazaltit në objektin “Rubik”, Bashkia Mirditë, të hiqet nga fondi pyjor publik i bashkisë, të zvogëlohet në volum dhe të çregjistrohet nga Regjistri i Kadastrës së Pyjeve dhe Kullotave. Lidhja nr. 1 me të dhënat për sipërfaqet pyjore që zvogëlohen në volum e hiqen nga fondi pyjor publik, si dhe harta topografike me koordinatat e poligonit të sipërfaqes, objekt i shfrytëzimit minerar, i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.

2. Vlerat përkatëse të volumit të materialit drusor dhe të produkteve të tjera pyjore, në sipërfaqen objekt shfrytëzimi, paguhen nga shoqëria “Vuthaj” sh.p.k., në llogarinë rrjedhëse të Bashkisë Mirditë, bazuar në vendimin nr. 391, datë 21.6.2006, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe kullotave”, të ndryshuar.

3. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, shoqëria “Vuthaj” sh.p.k. detyrohet të rehabilitojë sipërfaqet sipas kushteve të lejes mjedisore, të pyllëzojë me fondet e veta një sipërfaqe pyjore prej 7.652 (shtatë pikë gjashtëqind e pesëdhjetë e dy) ha në ngastrat e përcaktuara në marrëveshje me Bashkinë Mirditë.

4. Bashkia Mirditë dhe shoqëria “Vuthaj” sh.p.k. të nënshkruajnë marrëveshjen e bashkëpunimit jo më vonë se 60 (gjashtëdhjetë) ditë nga hyrja në fuqi e këtij vendimi. Një kopje e marrëveshjes, së bashku me projektet e miratuara për pyllëzimin, dërgohen në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit jo më vonë se 10 (dhjetë) ditë nga data e nënshkrimit të saj.

5. Sipërfaqet pyjore, sipas lidhjes 1, të këtij vendimi, mbeten pronë publike e shtetit dhe regjistrohen në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë.

6. Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Lezhë bën çregjistrimin e sipërfaqes pyjore të identifikuar, sipas lidhjes 1, të këtij vendimi, nga kategoria “tokë e zënë pyjore” dhe e regjistron në kategorinë “tokë e zënë, objekt shfrytëzimi për bazalt”.

7. Me përmbushjen e detyrimeve të përcaktuara në planin e rehabilitimit sipas lejes mjedisore nga shoqëria “Vuthaj” sh.p.k., sipërfaqja e rehabilituar të regjistrohet në fondin pyjor publik të Bashkisë Mirditë.

8. Ngarkohen Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Bashkia Mirditë, Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Lezhë dhe shoqëria “Vuthaj” sh.p.k., për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyj në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare

ZËVENDESKRYEMINISTËR
Erion Braçe

Bashkia MIRDITË


LISTA E NGASTRAVE DHE N/NGASTRAVE TË FONDIT PYOR PUBLIK QË
HIQEN PËR KRYERJEN E AKTIVITETIT MINERAK TË SHOQËRISË "VUTHAJ" shpk

Nr.	ID pronës	Ekonomia Pyjore/Kultivore	Ngastra/ n/ngastra	Sipërfaqja që hiqet nga fondi pyjor/ kultivor ha	Përdorimi territorit
1	2	3	4	5	6
1	LE19 00 008d	Kulme-Dervën-Fang	8d	0.485	binësi pyjore
2	LE19 00 010a	Kulme-Dervën-Fang	10a	1.957	trungishite
3	LE19 00 010b	Kulme-Dervën-Fang	10b	0.432	trungishite
GJITHSEJ				2.874	

MINISTËR
Blendi KALSI



HARTA TOPOGRAFIKE
EKONOMISE PYJORE "KULME DERVENIT-FANG"
SHKALLA 1 : 25 000



Kordinatat e objektit (Gauss Krüge)		
Nr.	Y	X
1	4399200	4625675
2	4399370	4625725
3	4399420	4625605
4	4399230	4625505

$S=0.029\text{Km}^2$

SHOQERIA "VUTHAJ" sh.p.k.			STUDIMI TEKNIKO - EKONOMIK DHE PROJEKTI I SHFRYTEZIMIT
ING Gjeodet: Gerard Lieshi 	Sip. ngastra 10/a = 5165.744m ² Sip. ngastra 10/b = 19578.236m ² Sip. ngastra 8/d = 4325.719m ²		Nr prones: 392 / 5 Nr ngastres: 8 /d, 10/a, 10/b Siperfaqe: 2.9 Ha
	SHKALLA 1: 25 000	DATA	Viz. Nr.1 OBJEKTI I BAZALTEVE "RUBIK", QARKU LEZHE ZONA MINERARE KONKURUESE Nr. 392/5